



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 19 Prot

Tiranë, më 10.01 2012

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, **Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr. 1, me adresë:** Rruga e Elbasanit, mbrapa Ambasadës Amerikane, Tiranë.

VENDIM

Nr. 01, datë 10/01 2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr.1, Tiranë.

KONSTATOVA

Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në Nenin 21 të tij.

Në pikën 1, të nenit 21 të Ligjit të mësipërm parashikohet : “Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë”. Ndërsa, në nenin 22 saktësohet përmbajtja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t’i njoftoni tek Komisioneri.

Në zbatim të Urdhrit Nr.67, datë 18.10.2011, pranë kontrolluesit “Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr.1”, është realizuar kontroll administrativ.

Lidhur me detyrimin ligjor për njoftim, sipas nenit 21 të ligjit nr.9887, dt 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ju si kontrollues jeni njohur më parë madje dhe me takime konkrete të inspektorëve të drejtorisë së Hetim Inspektimit me format sensibilizuese që KMDP ka aplikuar për këtë qëllim gjatë vitit 2010, në të cilat është insistuar që ky kontrollues duhet të përmbushë detyrimin ligjor për njoftim. Gjatë këtyre takimeve, nga ana jonë është vënë re që kontrolluesi nuk ka bashkëpunuar me inspektorët.

Gjithashtu, përsëri gjatë vitit 2011, në zbatim të Urdhërit Nr.67, datë 18.10.2011 të Komisionerit ju si kontrollues jeni vënë në dijeni për detyrimin për njoftim dhe për masat që duhet të merrnit për ta plotësuar atë.

Megjithatë, nga momenti i fillimit të kontrollit administrativ deri në mbarim të tij, si dhe deri më sot, ju nuk e keni realizuar këtë detyrim ligjor. Nga verifikimi i regjistrave të Drejtorisë së Regjistrimit, dhe Zyrës së Protokollit pranë Komisionerit rezulton se aktualisht ende nuk është përmbushur detyrimi për njoftim sipas Nenit 21 të Ligjit të sipërcituar.

Gjithashtu, bazuar në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte e konsiderojmë shkelje të rëndë përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Fakti që bërja publike, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit, është penguar për shak të mos njoftimit të përpunimit/ve që ju realizoni, mund të ketë penguar referencat e mundshme që subjektet specifike që ju u përpunoni të dhënat mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit/ve që ju realizoni.

Në këto kushte, mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor, ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma "d", të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku parashikohet dënimi me gjobë në masën nga 10.000 deri në 50.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe nenit 18/a,c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative";

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr. 1, Tiranë me gjobë 20 000 lekë.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë, 10.01.2012.

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (Pogaçe)

